

## STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" Media Place " shpk

### ME ADRESE

TIRANE Bulevardi "Bajram Curri", pallatet 1-Maji, Shkalla 6, Ap 55, Tirana-Albania.

Ne kete statut

"Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" "Statuti" eshte Statuti i shoqerise.

### KREU 1

Sot, datë 14 Gusht (katermbedhjete Gusht dymije e njezet e kater), themeluesi , ka krijuar një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, anetare themelues:

1. Ornella Cela, banor i Republikës Shqiptare, i lindur me 22.02.1999 mbajtës i kartës së identitetit nr.

**J95222019Q**

Vendosi të krijojë shoqerinë " Media Place " shpk me këto kushte:

### NENI 1

#### Emri i Shoqerise

Shoqeria është një entitet juridik privat. Shoqeria do të prezantohet në marrëdhënie civile dhe juridike me emrin: " **Media Place** " shpk.

### NENI 2

#### Objekti i Shoqerise

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Marketing, Menaxhim, Monitorim te Mediave Online etj.

### NENI 3

#### Kohëzgjatja e Shoqerisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pakufizuar dhe me të drejtë ripërtëritje. Ky afat fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Qendrës Tregtare të Biznesit.

Ortaku i Shoqërisë mund të vendos kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm të marrë prej një rezolute të Mbledhjes së Ortakëve.

### NENI 4

#### Adresa e Shoqerisë

Shoqeria është e bazuar në Tiranë, në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", pallatet 1-Maji, Shkalla 6, Ap 55, Tirana-Albania.

## KREU II KAPITALI

### NENI 5

#### Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 ALL (njeqind mijë leke)

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku themelues: Ornella Cela eshte zoterues i 1 kuote (nje kuote) me vlore 100.000 leke ( njeqind mijë), ekuivalente ne masen 100% te kapitalit themeltar te shoqerise

## NENI 6

### Zmadhimi dhe Zvogelimi i kapitalit

Shoqeria mund tē shtojë ose zvogëlojë kapitalin nē varësi tē nevojave dhe rezultateve tē saj sipas vendimit tē ortakeve.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

## NENI 7

### Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit tē një shoqerie me përgjegjësi tē kufizuar e tē drejtat që rrjedhin prej tyre mund tē fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit nē kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër tē parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme ndërmjet ortakëve, pér sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

## NENI 8

### Organë Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarrës i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse pér marrjen e vendimeve pér shoqerinë pér çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare tē shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe tē ekspertëve kontabël tē autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve pér personat e përmendor nē shkronjat "c" dhe "ç" tē kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit tē politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raporteve tē ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raporteve tē ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë nē gjykatë dhe nē procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale tē mbledhjeve tē asamblesë;
- i) çështje tē tjera tē parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund tē përfaqësohet nē asamblenë e përgjithshme, nē bazë tē një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund tē veprojnë si përfaqësues i ortakëve nē asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund tē jepet vetëm pér një mbledhje tē asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me tē njëtin rend dite.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet tē përbajë vendin, datën, orën

e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar përmbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, përfundimisht parregullsisë.

### Neni 10 Korumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë përfundimisht qështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet përfundimisht që shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rezultat.

### Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendllohet me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, përfundimisht e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendllohet me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, përfundimisht qështje te tjera si a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve; c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; ç) përcaktimin e shpërblimeve d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statutit duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim përfundimisht:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bëre në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme

Administratori i shoqerise " Media Place " shpk do të jetë:

**Ornela Cela**, banor i Republikës se Shqiptarise, i lindur 22.02.1999 mbajtës i kartës së identitetitit nr. **J95222019Q**  
Administratori do të qëndrojë në detyrë per një periudhe 5 vjecare.

Nga data 14.08.2024 deri në 13.08.2029 dhe mund të rikonfirmohet në detyre me një rezolutë specifike të Mbledhjes së Oratkeve.

#### **Neni 14 Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përrpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryej detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus; b) të ushtroj kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanjoë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për t'u bërë kështjellë.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit

Kanë të drejtë të ligjore padri penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREUZ

## Viti finansiar-ekspertet

Nenj 16

Viti Financier

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Nenj 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe tё kontrolloje tё gjithe dokumentacionin kontabel tё veprimitarise ekonomiko tregtare tё shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike tё ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka krver nie gie tё tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte idetyruar qe t'ja paraqese e dorezoie ne kohe ortakeve per t'i shqyrta e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

Kreul V

## Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Nenj 18

Prishja dhe likuidimi Shperndaria

ose prishia e shqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;  
d) me vendim të givkatës;

d) me vendim të gjykatës,  
Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë “Shoqeri ne likuidim e siper.”

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përiashtim të rasteve kur është nisur nië procedurë falimentimi.

Likuwidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Nenj 19

05

### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **Neni 20 Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 21 Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata e Tiranes.Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata e Tiranes.

#### **Neni 22 Dispozita te fundit**

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne ndonje Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashte Shqiperise.

Shoqeria do te kete vulen e saj, forma cdhe rradhesia e se ciles do te percaktohet nga ortaket.

Ky statut eshte hartuar ne 4 (kater kopje, ne gjuhen shqipe, duke patur secila fuqi te njejtë ligjore.

*ORTAKU*

*I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR*

**Media Place**

*Ornela Cela*

*Ornela Cela*

*OG*

Pag. 6 di 6